



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 3-10/2022 regjistër (JR)
Datë 19.02.2026

Nr. 12/1 i vendimit
Datë 28.04.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.04.2026, ditën e martë, në orën 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, kërkesën që i përket:

KËRKUES: Arben Dosti.

OBJEKTI: Sqarim, interpretim dhe plotësim i vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelistit.

BAZA LIGJORE: Nenet 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelistit,

pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuarit Arben Dosti, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), në të cilën kërkoi sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelistit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Dosti, në datën 30.01.2026 është njohur me vendimin me arsyetim të plotë, me nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”). Sipas këtij vendimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 479, datë 03.12.2021, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

2. Në datën 19.02.2026, kërkuesi Arben Dosti (në vijim “kërkuesi”) ka paraqitur një kërkesë përpara Kolegjit, regjistruar me nr. {***} prot., datë 19.02.2026, nëpërmjet së cilës ka kërkuar sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit.

II. Kërkesa e kërkuesit Arben Dosti

3. Kërkuesi është shprehur në kërkesën e tij, në mënyrë të përmbledhur, se vendimi i Kolegjit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 është i paqartë, i paarsyetuar dhe në kundërshtim me shumicën e provave të paraqitura prej tij gjatë procesit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ashtu edhe gjatë procesit në Kolegj. Kolegji nuk ka marrë në analizë shumë prova të paraqitura prej tij në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, pothuajse plotësisht ato të paraqitura gjatë gjykimit në Komision dhe marrë në konsideratë prej tij në vendimmarrjen për konfirmimin në detyrë. Sipas kërkuesit, në kushtet kur Kolegji kishte një qëndrim plotësisht të kundërt me analizën dhe vendimmarrjen e Komisionit, sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe atij të vlerësimit të aftësive profesionale, barra e arsytimit për të duhet të ishte maksimale dhe nuk duhej të mjaftohej vetëm me një interpretim të ndryshëm subjektiv. Kërkuesi ka pretenduar se mungesa e analizës profesionale, arsytimit dhe mbështetjes në ligj ose jurisprudencë e qëndrimit të kundërt të Kolegjit me atë të Komisionit, si dhe mosanaliza totale e provave të paraqitura prej tij gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, e kanë vendosur atë në kushtet e pamundësisë për të ushtruar substancialisht të drejtën e tij për ankim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
4. Për sa më sipër, kërkuesi ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe sqarimin, interpretimin dhe plotësimin e vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit.
5. Në datë 27.03.2026, kërkuesi paraqiti kërkesën e regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 27.03.2026, në të cilën ka kërkuar që gjykimi i kërkesës për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, të zhvillohet në seancë gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

6. Në përputhje me nenet 65 dhe 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si dhe nenet 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e kërkesave për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimeve të dhëna prej tij, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Për rrjedhojë, kërkesa në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt sqarimin, interpretimin dhe plotësimin e një vendimi të Kolegjit, i cili ka vendosur përfundimisht për rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arben Dosti, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të kërkesës

7. Shqyrtimi i kërkesës së kërkuesit për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit, u krye nga trupi gjykues në dhomë këshillimi, fillimisht, në datën 30.03.2026. Në këtë seancë, në vijim të kërkesës së kërkuesit të regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 27.03.2026, në të cilën ka kërkuar që gjykimi i kërkesës për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit, të zhvillohet në seancë gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi shtyrjen e seancës gjyqësore, për t’i njoftuar Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkesat e paraqitura nga kërkuesi Arben Dosti. Trupi gjykues ftoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme¹, në cilësinë e palës në gjykimin e çështjes (JR) 10/2022, datë 15.02.2022, që i përkiste ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit nr. 479, datë 03.12.2021 për subjektin e rivlerësimit Arben Dosti, e përfunduar me vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, të mbante një qëndrim lidhur me kërkesat e kërkuesit Arben Dosti. Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 08.04.2026², Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme paraqiti qëndrimin e tij sipas të cilit, duke mbajtur në konsideratë që gjykimi i çështjes në zbatim të parimit të kontradiktoritetit me praninë e palëve ka përfunduar, si dhe në kushtet kur ai vetë nuk ka ngritur pretendime në drejtim të plotësimin, sqarimit dhe interpretimit të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, trajtimi i mëtejshëm i objektit të kërkesës mbetet në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit. Qëndrimi i sipërcituar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme iu bë i njohur edhe kërkuesit Arben Dosti. Trupi gjykues, në seancën gjyqësore të datës 23.04.2026, me vendim të ndërmjetëm, vendosi shtyrjen e saj për në datën 28.04.2026, për t’i njoftuar vëzhguesit ndërkombëtar qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme lidhur me kërkesën e kërkuesit.

8. Në analizë të kërkesës për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit, në seancë gjyqësore në prani të palëve, trupi gjykues vëren se kërkuesi ka argumentuar se shqyrtimi në dhomë këshillimi i kërkesës cenon të drejtën e tij për t’u dëgjuar dhe ballafaquar drejtpërdrejt me palën tjetër Komisionerin Publik, ashtu edhe me gjykatën. Sipas kërkuesit, shqyrtimi i kërkesës në seancë gjyqësore në prani të palëve është garanci më tepër për respektimin e palëve ndërgjyqëse, si dhe ndihmon gjykatën në dhënien e një vendimi sa më të drejtë, ndërsa e kundërta do të cenonte të drejtën e palëve ndërgjyqëse të njohur dhe parashikuar shprehimisht në Kushtetutë e në ligj, si dhe është shkelje e parimit të kontradiktoritetit, të drejtës

¹ Me shkresën nr. {***} regj., datë 30.03.2026, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u njoftua me kërkesat e paraqitura nga kërkuesi Arben Dosti.

² Shkresa e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me nr. {***} prot., datë 08.04.2026, regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 09.04.2026.

për t'u dëgjuar dhe paraqitur argumenta verbalisht përpara gjykatës, në shkelje të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

9. Në vijim të analizës, trupi gjykues vlerësoi se në zbatim të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Në vijim të këtij parashikimi, neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se procesi gjyqësor në Kolegj kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1, 49, 51, dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Prosesi gjyqësor në Kolegj, si rregull, zhvillohet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, në përputhje me parashikimin e nenit 49, pika 1 e ligjit 49/2012, ndërsa rastet përjashtimore të zhvillimit të gjykimit në seancë gjyqësore publike, janë parashikuar nga neni 51 i po këtij ligji. Sa më sipër, trupi gjykues nuk e çmoi të nevojshëm kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, për faktin se argumenti që paraqet kërkuesi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike nuk parashikohet në rastet specifike, sipas kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.

Trupi gjykues vlerësoi se objekti i kërkesës së paraqitur nga kërkuesi bie në rregullimin e parashikuar nga nenet 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile, që legjitimojnë gjykatën që të plotësojë, sqarojë dhe interpretojë vendimin që ajo ka dhënë. Zbatimin e neneve 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile e dikton parashikimi i nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, dispozita të cilat orientojnë Kolegjin në aplikimin e normave të Kodit të Procedurës Civile, në rast se situatat ligjore të prezantuara për zgjidhje nuk gjejnë një zgjidhje të posaçme nga vetë ligji nr. 84/2016.

Në përputhje me përmbajtjen e dispozitave të sipërcituara, kërkesa e kërkuesit u shqyrtua nga i njëjti trup gjykues i Kolegjit që ka dhënë vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025.

Trupi gjykues vëren se neni 313, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, parashikon thirrjen e palëve në shqyrtimin e kërkesës për plotësimin e vendimit. Në kuptim të këtij parashikimi, trupi gjykues e konsideroi të ezauruar thirrjen e palëve në këtë çështje, pasi nëpërmjet komunikimit shkresor të analizuar më sipër në këtë vendim, u njoh edhe me qëndrimin e palës tjetër në gjykimin e çështjes për të cilën ka dhënë vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili është shprehur se gjykimi i çështjes në zbatim të parimit të kontradiktoritetit me praninë e palëve ka përfunduar³.

10. Për sa më sipër, trupi gjykues vendosi refuzimin e kërkesës dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentacionit të fashikullit të çështjes.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me kërkesën për sqarim, interpretim dhe plotësim vendimi

³ Në gjykimin e zhvilluar në Kolegj, në përfundim të të cilit trupi gjykues disponoi me vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerit Publik, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, u bë kalimi procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

11. Trupi gjykues lidhur me pretendimet⁴ e kërkuessit për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, analizoi si vijon.
12. Trupi gjykues vëren se kërkuessi ka pretenduar se arsyetimi i vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit ka parregullsi në drejtim të interpretimit dhe sqarimit të vendimmarrjes, përfshirjen dhe marrjen në analizë të fakteve ose interpretime të paqena në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, mospërfshirjen dhe mosanalizimin e shkakut të mospranimit të kërkesave të tij, mosarsyetim ose analizë të cekët të vendimmarrjeve të ndërmjetme, mospërfshirje, verifikim dhe vlerësim të provave të paraqitura, veprime ose mosveprime këto që cenojnë të drejtën e tij për të patur një vendim të qartë, të mirëarsyetuar ku të gjejnë pasqyrim të gjitha pretendimet dhe provat e paraqitura prej tij, me qëllim pasjen e mundësisë jo vetëm formale, por edhe substanciale për të kryer ankim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
13. Trupi gjykues vëren se dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cilat janë thirrur nga kërkuessi për të bazuar kërkimet e tij, kanë përcaktuar qartë kushtet në të cilat mund të kërkohet sqarimi, interpretimi dhe plotësimi i vendimit të dhënë nga gjykata.
Neni 313, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se: *“Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit, mund të kërkojë plotësimin e vendimit, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova.”*, ndërsa neni 314, paragrafi i parë i të njëjtit Kod parashikon se: *“Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët.”*
14. Trupi gjykues ka marrë vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, në përfundim të gjykimit të iniciuar nga ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 479, datë 03.12.2021 dhe të zhvilluar në seanca gjyqësore publike në prani të palëve, në përputhje me parashikimin e nenit F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Kërkuessi në cilësinë e subjektit të rivlerësimit nuk ka paraqitur kundërankim ndaj ankimit të Komisionerit Publik, por ai i ka parashtruar prapësimet e tij mbi këtë ankim duke paraqitur prova në mbështetje të tyre, gjatë zhvillimit të gjykimit në Kolegj.
Pas njohjes me kërkesën e kërkuessit për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12, datë 13.02.2025 të Kolegjit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në cilësinë e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet paraqitjes së ankimit, duket se nuk ka patur asnjë pretendim në drejtim të sqarimit, interpretimit dhe plotësimit të këtij vendimit, pasi në qëndrimin e tij drejtuar Kolegjit është shprehur se, duke mbajtur në konsideratë që gjykimi i çështjes në zbatim të parimit të kontradiktoritetit me praninë e palëve ka përfunduar, si dhe në kushtet kur ai vetë nuk ka ngritur pretendime në drejtim të plotësimit, sqarimit dhe interpretimit të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, trajtimi i mëtejshëm i objektit të kërkesës mbetet në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit.
15. Lidhur me pretendimet e kërkuessit, në raport me rrethanat dhe faktet e rastit konkret në shqyrtim, trupi gjykues vëren se ndonëse kërkesa është paraqitur në kuptim të neneve 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile, në thelb kërkuessi kundërshton qëndrimin e mbajtur dhe mënyrën e trajtimit të pretendimeve të tij në vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit. Edhe pse në objekt të kërkesës është kërkuar sqarimi, interpretimi dhe plotësimi i vendimit, pretendimet e kërkuessit kanë të bëjnë me arsyetimin e trupit gjykues në vlerësim të kërkimeve të paraqitura në ankimin

⁴ Sipas përmbajtjes së kërkesës së paraqitur në Kolegj nga kërkuessi Arben Dosti, regjistruar me nr. {***} prot., datë 19.02.2026.

e Komisionerit Publik, duke mos qenë dakord me këtë vlerësim dhe duke pretenduar se ai është rrjedhë e evidentimit të pasaktë e jo të plotë të rrethanave, fakteve, dhe provave, duke kundërshtuar mënyrën se si ato janë analizuar dhe vlerësuar, duke vënë në diskutim përfundimet e arritura në vendim. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se vendimet e dhëna nga Kolegji nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli bazuar në parimin që pas shpalljes së vendimit, gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Pretendimet e kërkuarit për sqarim, interpretim dhe plotësimin e vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025 të Kolegjit, të analizuar më sipër, në vlerësim të trupit gjykues, nuk plotësojnë kushtin e kërkuar përkatësisht nga neni 313, paragrafi i parë dhe neni 314, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile.

16. Trupi gjykues vlerëson se në vendimin nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, është shprehur mbi të gjitha pretendimet e paraqitura nga Komisioneri Publik në ankim, ka analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të mirëargumentuar provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe situatën faktike që rezultonte për çdo shkak ankimi, si dhe pretendimet e provat e subjektit të rivlerësimit në prapësim të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkluzionet e arritura për secilin shkak ankimi janë rezultat i një arsyetimi të plotë, duke i dhënë përgjigje të gjitha kërkesave për të cilat kërkuari ka paraqitur prova, si dhe një arsyetimi të qartë të mbështetur në analizën e provave të pranuar në procesin gjyqësor në kuptim të ligjit të zbatueshëm.
17. Bazuar në konkluzionet si më sipërsyrtuar, trupi gjykues vlerëson se kërkesa e kërkuarit Arben Dosti për sqarim, interpretim dhe plotësim të vendimit nr. 12 (JR), datë 13.02.2025, të Kolegjit, është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 313 dhe 314 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës nr. 3-10/2022 (JR), datë 19.02.2026 të kërkuarit Arben Dosti.
2. Të njoftohet kërkuari me këtë vendimmarrje.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.04.2026.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi